

VENDIM
Nr.1514, datë 19.11.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE DHE DEGA E DOGANËS SË TIRANËS, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe degës së doganës së Tiranës, të përfundojë, deri në datën 29 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit, për mallra e shërbime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar, në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Aneksi i vendimit të Këshillit të Ministrave

Në lekë

Nr.	EMËRTIMI I PROJEKTIT	VLERA
	Drejtorja e Përgjithshme e Doganave	
1	Pajisje zyre dhe elektronike	
	- Loti II “Blerje dhenesa peshe”	4,600,000
	- Loti III “Blerje softwar-i antivirus”	2,163,000
	Dega e doganës Tiranë	
1	Shtrim asfaltim i sheshit	8,100,000
2	Ndërtim i pikës së kontrollit fizik	4,120,800